

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-23-4552-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	DEFENCE SECURITY SH.P.K.
NUI	812016849
Adresa	PRISHTINË
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	048 911 119
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	BEKIM HOTI
Adresa elektronike	defencesecur@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	16.08.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut

Njoftimi për kontratë 19.05.2023

Hapja 12.06.2023

Vendimi i AK 02.08.2023

Kërkesa për Rishqyrtim 07.08.2023

Pergjigjia e AK 09.08.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

PO nuk kemi pasur verejtje

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

PO kemi bërë por nuk na është shqyrtuar

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
- Neni 27 Dosja e Tenderit.
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar

Bazuar në LPP kunërshtojmë në tërësi vlerësimin e AK-së pasi që nuk e keni bërë conform LPP-së dhe Udhëzimeve Administrative,


Lidhur me AP tuajin ku keni cekur lidhur me pagësn se OE duhet të

- Duke marrë parasysh rëndësinë e objekteve që duhet të ruhen si dhe nivelin stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçantë për autoritetin kontraktues. Paga minimale bruto bazë (te pagesave shtesë dhe lejimeve konform Ligjit të Punës në fuqi), për roje fizike të angazhuar në këtë kontratë duhet të jetë jo më pak se 386 € në muaj. Ky çmim është për ndërrimin e pare. Kontraktori është i obliguar që të respektojë Ligjin e punës dhe Udhëzimin Administrativ të MPMS Nr. 09/2017 . Në këtë rast Kontraktori obligohet të paguaj shtesë mbi pagën bazë për ndërrimin e dyte dhe te trete dhe festa. Kontraktori obligohet të furnizojë edhe një shujtë të ngrohtë për çdo ndërrim.

Duke iu referuar Ligjit të punës në fuqi dhe UA të ndërlidhura, fondi orëve për një

muaj është 176 për një muaj.

Pra ju keni sakëtësuar se OE duhet ta respektoj LIGJIN E PUNËS dhe Udhëzimet tjera Administrative për të mbrojtur të drejtat e punëtorve por në raportin e datës 26.07.2023 ju në këtë rastë antarët e komisionit kanë bërë më shumë “vlerësim” sipas tekeve të tyre dhe jo sipas kërkesave këtë e themi sepse në faqen nr 17 të këtij raporti ju keni paqyruar si vijon:



Pra këtu shifet qartë se këta antar komisioni kanë fshehur duke tentuar të mashtrojnë një pjesë të kërkesave të DT-së dhe të drejtave të punëtorve ku sipas Ligjit të Punës e drejtë themelore e secilit të punësuar pas marrëjes së pagës është pushimi vjetor /zëvendësimi kjo ceket qartë në nenin

Neni 32 Pushimi vjetor 1. I punësuar gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.

Pra vërehet qartë se ky detaj nuk është kalkuluar në këtë “analizë” ku për koiqidendë edhe OE I rekomanduar për kontratë ka paraparë këtë të drejtë të paraparë me Ligj.

Po ashtu komisioni nuk ka kalkuluar as festat zyrtare ku janë kërkuar dhe nuk e ka

përfshirë sipas kërkeses tuaj.

Po ashtu tek vlera e sigurimit shëndetësor ka vendosur një vlerë të pabazuar por vetëm supozuese vlerë e cila është më pak se 6 euro që nuk ka ndonjë mundësi të zbatohet kërkesa juaj.

Raporti nuk është I votuar unanimisht dhe ka kundërthënje mes antarëve të komisionit dhe nuk e kuptojm mbi qafër bazë është rekomanduar në OE I papërgjegjshëm.

Me datë 03.08.2023 kemi pasur qasje në ofertën e OE të rekomanduar dhe pamë se ky OE ka edhe mungesë të dokumentacioneve dhe nuk ka plotësuar respektuar kërkesat e AK, OE në fjalë nuk ka ofruar si propozim kërkesen tuaj në ANEKS 1 përkatësisht pika 7 nënkërkesa d. Me qellim të rritjes së efektivitetit të sigurisë në objektet e veta, Autoriteti Kontraktues e konsideron si domosdoshmëri monitorimin e rojeve neper objektet e saja ne kohe reale përgjatë gjithë kohës (24/7/365). Për tu arritur kjo Autoriteti Kontraktues kërkon qe kompanitë e sigurimeve te posedojnë zgjidhje elektronike qe do te mundësonte kontrollin e rojeve ne terren ne kohe reale gjate tere kohës. Softuerin dhe infrastrukturën përkatëse qe i mundëson Autoritetit Kontraktues te beje monitorimin e rojeve.

Po ashtu ky OE është I papërgjegjshëm pasi që nuk ka respektuar kërkesen tuaj ku keni kërkuar që •Për shujte me një ofrues te shërbimeve te ushqimit. (kosto e shujtës ditore nuk mund te jete me e ulet se 2.00€)

Në analizën e ofruar nga ky OE deklarohet se çmimin për shujtë e ka ofruar në vlerë prej 1.13 që dëshmon se nuk ka respektuar kërkesen e dosjes së tenderit,

Provë analiza financiare

Tek menaxherat osht bo ndryshim çmimi gjë që osht në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit kjo per arsye se ky ka dhen çmim për një ditë me vlerë prej $113.60 \times 365 = 41,464.00$ kurse në analizë 36 mijë edhe ktu është ndryshim në aspektin material.

Sa për korrektësi ne po bashkangjesim analizën ton e cila është e përpiluar conform kërkesave tuaja në DT.

Të nderuar bazuar në kërkesen tuaj më poshtë gjeni Analizen e detajuar.

Nr	SQARIMI	VLERA	TOTALI
----	---------	-------	--------

1.	Pagat duke perfshire te gjitha ndrrimet jane	371 x 422.9x 12 muaj	1,882,751.00 €
2.	35 punonjes shtese si zevendesues	35x386x12	162,120.00 €
3.	Pagat e menaxhereve 4 1 Projekt menagjeri	119.20*22*12	31,468.80 €
4.	Per festa eshte parapare nje buxhet prej	12 festa	7,500.00 €
5.	shujta x 2 € x 365	286*2*365	208,780.00 €
6.	Sigurimi shendetsor	406*7*12	34,104.00 €
7.	Fitimi	101.41*12	1,216.88 €
8.	Totali	Totali	2,327,940.68 €
9.	Totali me TVSH	Totali me TVSH	2,746,970.00 €

Sa I përket uniformav dhe paisjeve tjera ne në depo kemi uniforma të mjaftueshme për t'i pajisur të gjithë punetorët e angazhuar në këtë kontratë. Gjithashtu, grupi jonë ka pajisje të mjaftueshme për t'i pajisur te gjitha pikat sipas kërkeses se specifikimit teknik

Kompania jonë është e fokusuar në bashkpunimë afatgjatë dhe rendesi të vacanta janë referencat meqrast në këtë tender kemi paraparë fitim minimal për të mos thënë fare.

Të gjitha ofertat që janë nën çmimin e ofruar janë të papërgjegjshem.

Me datë 07.08.2023 kemi pranuar me email një document nga ju çertifikaten e ekspertit për shendet dhe siguri në punë dhe listen për verifikim dhe pamë se sipas nr të çertifikates me nr 233 del të jetë person tjetër që shfaq dyshimin tonë se kjo çertifikatë nuk është valide.

Provë liste e shkakuar nga sistemi në linkun që keni dërguar dhe qertifikata e dërguar nga ju.

Duke u bazuar në të gjeturat nga ana jonë dhe shkeljet që janë bërë kërkojm nga ana juaj që të aprovonit kërkesen tonë për rishqyritm duke shpallur ofetren tonë si më të lirën të përgjegjshme.

AK përveq se nuk marrë mundin të na shqyrtoj kërkesen tonë conform nenit 108/A ku në kërkes për ri-shqyrtim kemi ofruar mjaftë argumente se ka shkelje esenciale të ligjit madje ka edhe ndryshim në aspektin material të ofertës dhe se me kërkesen të cilën AK cekë

Po ashtu ky OE është I përgjegjësëm pasi që nuk ka respektuar kërkesen tuaj ku keni kërkuar që •Për shujte me një ofrues te shërbimeve te ushqimit. (kosto e shujtës ditore nuk mund te jete me e ulet se 2.00€)

Në analizën e ofruar nga ky OE deklaroi se qmimin për shujtë e ka ofruar në vlerë prej 1.13 që dëshmon se nuk ka respektuar kërkesen e dosjes së tenderit,

Ky mos zbatim I kërkesës e bënë direkt të pa përgjegjësëm këtë OE. Por AK nuk e ka marrë për bazë dhe na ka vendosur në lajthitje edhe neve se nëse një kërkes e tillë nuk ish dashur të “zbatohet” pse ka kërkuar një gjë të tillë përderi sa nuk është bërë vlerësimi konform kërkesave.

Me këtë ankesë janë të bashkangjitura edhe provat siq janë:

Raporti I vlersimi 1&2

Sqarimet (analizat e OE të rekomanduar)

Dhe dokumente tjera relevante

Duke u bazuar në dëshmit e ofruara kërojm që të APROVONI ankesen tonë dhe AP të këthehet në RIVLERËSIM duke e detyruar AK që të veproj conform LPP-së, Kërkesave të DT-së për të shpallur ofertën tonë si më të lirën të përgjegjësme.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Të medha perfshir kohen dhe stresin e shkaktuar

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.